

RAPORT TEKNIK

**Objekti : “REHABILITIMI I SHESHEVE, GODINAVE
DHE QENDRES SE QYTETIT”**

Bashkia HAS

Autor i Projektit

“ERALD - G” shpk

2016

PLANI I NGJYRAVE PER GODINAT:

Rruga “Egnatia”, Rruga ”A.Goga” e Rruga “S. Beja”, Rruga “Deshmoreve”, Rruga “H. Podgorica”, Rruga “K. Rama”, Rruga “Taulantia”, Rruga “Mujo Ulqinaku”

Hasi eshte nje qytet me relief kodrinoro malor me nje lartesi 400-500m mbi nivelin e detit. Shtresezimi kaotik i pas viteve 90, pakujdesia e trajtimit te godinave, rruget te gjitha te njejta, percpetohen sot si nje aglomerat homogjen ne shkallen kromatike te godinave e rrugeve, me theks ne nderhyrje te guximshme qe bien shume ne sy.

Ne vitet e fundit jane bere shume nderhyrje ne hapësiren publike dhe keto operacione po e rforcojne qendren. Nje nderhyrje e perqendruar ne godina mund te qartesoje zona te caktuara te qytetit, ti vleresoje ato, te vendose nje hierarki te hapësirave e rrugeve, mund te nxjerre ne pah karakteristika te “zonave” te caktuara si dhe seciles prej rrugeve.

Rishikimi sot i thurjes urbane, nepermjet godinave te vazhduara e te vecanta, na ka ndihmuar te kuptojme qe perballe nje homogjeniteti te rrafshet.

Ne llogjiken e nje leximi te rregullt te qendres, si edhe per te percaktuar kriteret e sakta per nderhyrjen ne fasada, kemi ndare dhe rimontuar si nje kolazh zonen e nderhyrjes, duke krijuar njehierarki te sakte.

POLET URBANE_Hapësira te zgjeruara ne shkalle te madhe, zonat e lidhjes me rruget

Te gjitha rruget e qendres “derdhen” ne hapësira me te gjera, ne forma pak a shume te rregullta. Ndertesat perqark ketyre hapësirave kane dimensione te konsiderueshme. Do te trajtohen ne menyre homogjene, ne mbeshtetje te hapësires strategjike nga kane fasadat; jane me kufizime qe nuk takojne me njeri-tjetrin, por strukturojne perimetrat e zgjeruar te ketyre hapësirave.

Poli i I jane godinat perreth lulishtes kryesore te qytetit; **Poli i II** eshte rreshti i dyte i godinave, ky pol konsiderohet pothuaj qendra e qytetit duke

RAPORT TEKNIK

“REHABILITIMI I SHESHEVE, GODINAVE DHE QENDRES SE QYTETIT”

qene se godinat jene ne te njejten rruge me bashkine e qytetit; **Pol i III** eshte rruga kryesore e qytetit ajo me dy korsi e cila permban disa prej fasadave me karakteristike te qytetit; **Pol i IV** eshte rreshti i fundit i godinave, jane godinat qe i largohen me shume qendres se qytetit dhe ne vetvete konsiderohen nje qender e dyte e qytetit.

LULISHTJA DHE SHESHI

Eshte marre parasysh rehabilitimi i sheshit dhe lulishtes prane qendres se qytetit. E gjithë kjo pjese qe ndodhet midis polit I dhe polit II te trajtuar me siper do te preket me te gjitha punimet. Do te behet trajtimi i barit duke filluar nga plehrat kimike dhe organike dhe humus. Pastaj do te behet dhe mbjellja e barit. Ne lulishte do te behet dhe mbjellja e pemeve dhe shkurreve sipas percaktimit te projekt preventivit. Bordurat do jene te reja dhe trotuari do te behet me pllaka betoni me nje shtrese betoni dhe cakelli nen te. Muri pergjate lulishtes do te vishet me pllaka guri dekorative.

CATITE

Catite e ndertesave qe merren parasysh ne kete projekt do te ndertohen sipas planeve te dhena ne fletet e projektit. Do te behen me pjerresi 30 grade me kapriata druri. Te gjithë catite do te jene me 4 plane kullimi dhe ne secilin plan do te kene ulluk shkarkimi horizontal dhe ne pikat e derdhjes kaseta shkarkimi dhe ulluqe shkarkimi vertikal.

Materiali i perdorur do te jete tjegulla vendi.

NGJYRAT

Gamat e ndryshme kromatike jane zgjedhur ne baze te rradhes dhe kritereve qe morem nga leximi i qytetit, variacione te zëna ose të ndezura, variacione te ngrohta apo të ftohta.

Kemi perdorur sistemin NCS, me te perdorurin per aplikimet ne ndertim.

Nje zgjedhje e gjere te bardhash, grish dhe gri-bojeqielli, ne tonet e celta dhe te erreta, te ngrohta e te ftohta, eshte perdorur per nderhyrje te

shenjestrura ne ndertesat e periudhes racionaliste, por edhe per te gjithë pjesët strukturore te vijueshmerise urbane, si “kurorezimi”, kornizat, bazamentet.

Ngjyrat e verdha dhe GRI ne variacionet e tyre, te zëna te celeta, mesatare, me te ndezura, jane perdorur aty ku kane qene me parë dhe jane tipar dallues i ndertesës; duke i perdorur me pas me gjeresisht per te krijuar vijueshmeri dhe tipare homogjene te rrugeve. Ky eshte rasti i bllokut te godinave 1-6, ne lindje me te verdha, me tonet e lehta te okres. Godinat ne fjale rrethojne nje prej lulishteve te qendres se qytetit te Hasit te cilat harmonizojne ngjyren e verdhe me ngjyren e gjelbert te lulishtes.

Bloku i godinave 1-6: do te jete me se shumti ne tonet e se verdhes dhe reres, me volumet e nxjerra me ngjyrat dhe variacionet e kuqerremtes per te permiresuar aspektin vizual. Nderthurja e ngjyres se verdhe do te behet me ate gri duke bere thyerjen e ketyre ngjyrave ne pjese te caktuara te ndertesave.

Bloku i godinave 8-14: ndahen ne dy nenkategorji. Ndertesat 8 dhe 9 jane ndertesat e para qe fillojne e i largohen lulishtes me te madhe ne qendren e qytetit. Ketu ngjyrat jane po ashtu si ne rastin e godinave te bllokut te pare. Dominojne serish ngjyrat e verdha te celeta dhe ne volumet e dala si ballkone ngjyrat e kuqerremta. Ka thyerje te medha ngjyrash ne siperfaqe me ngjyren gri. Nderkohe ndertesa 12-13-14 jane nje bllok i vecuar ndertesash ne volum me te vogla se ndertesat e siperpermendura. Ketu nuk eshte perdorur thyerja e madhe e ngjyres se verdhe me ate gri por jane perdorur vetem shirita, qe jane dhe volume te dale nga ndertesa me ngjyren gri.

Bloku i godinave 16-18: Keto godina ndodhen si fasade e rruges kryesore qe te con ne sheshin e qytetit te Has-it. Ketu ka ndodhur nje thyerje thelbesore ne krahasim me fasadat e tjera. Jane perdorur ngjyrat me te ndezura dhe i eshte dhene nje ton me portokalli ngjyres se verdhe te perdorur me pare ne fasadat e mesiperme. Ngjyra gri eshte eliminuar pothuajse fare duke e bere ate irrelevante ne ndertesat qe sa vijne e i

RAPORT TEKNIK

“REHABILITIMI I SHESHEVE, GODINAVE DHE QENDRES SE QYTETIT”

largohen gjelberimit. Kjo per shkak se ne keto fasada nuk ka ngjyre te gjelber qe ta ndihmoje ne gjallerimin e ngjyrave. Ngjyra gri ketu perdoret vetem ne xokolaturat e ndertesave. Ne volumet e dala vazhdohet te perdoret ngjyra e kuqerremte.

Blloku i godinave 19-23: jane godinat te cilat jane rreshti i fundit persa i perket largesise nga gjelberimi. Per kete eshte bere irrelevante ngjyra e verdhe dhe eshte perdorur me shume ngjyra jeshile qe jep kontrastin mes grise se asfaltit dhe qytetit ne kete pjese dhe gjelberimit ne pjesen tjeter. Ngjyra gri eshte eleminuar nderkohe si thyerje eshte perdorur ngjyra e kuqerremte.

Ne nje situate shume te perzier dhe çrregullimi, zgjedhja e perdorimit te nje serie te kufizuar ngjyrash i korespondon vullnetit per te qartesuar strukturen urbane, per te bere te lexueshme arkitekturen perberese. Kjo nuk do te thote qe ne fazat e realizimit nuk mund te shtohen tonalitete te tjera, ama me kusht qe te respektohen udhezimet dhe principet e pergjithshme ideore te thena me siper.

Edhe kur nuk jane te pershkruar ne menyre te detajuar ne vizatime, te gjithë elementet arkitektonike qe karakterizojne ndertesat, si kornizat, kollonat, kangjellat me dizajno origjinale, muret me tulla ne dukje etj. do te ruhen si ne origjinal. Me rijetezimin e fasadave do te eliminohen te gjithë elementet e shtuar (mbulime me materiale plastike apo druri, mbyllje provizore etj.) qe bien ndesh me arkitekturen origjinale, duke shtuar imazhin e crregullimit dhe konfuzionit ne dizajn.